


UNIVERSITETI I
EJLJIE
УНИВЕРСИТЕТ
SEEU UNIVERSITY



FAKULTETI I BIZNESIT DHE
EKONOMISË
ФАКУЛТЕТ ЗА БИЗНИС И ЕКОНОМИЈА
FACULTY OF BUSINESS AND
ECONOMICS

DREJTIMI: FINANCA DHE KONTABILITET

TEZË MAGJISTRATURE

Roli i kreditimit në zhvillimin e bizneseve të vogla:rasti i procredit bank në Kosovë-Mitrovicë

KANDIDATI:

MIRSAD BEKTESHI

MENTORI:

PROF.DR. NASIR SELIMI

TETOVË, 2018

Falënderime

Falënderoj Allahun që ma mundësoi të përfundoj me sukses rrugën time të nisur disa vite më parë.

I jam mirënjohës dhe falënderues prof. Nasir Selimi i cili me shumë përkushtim më ofroi ndihmën e tij të madhe drejt finalizimit të këtij punimi.

Faleminderit familjes sime e cila gjithmonë besoi në mua.

Një falenderim shumë të madh edhe për të dashurën time e cila më mbështeti fuqimisht gjatë studimeve.

ABSTRAKT

Qëllimi kryesor i realizimit të këtij studimi në këtë tezë magjistrature është ofrimi i të dhënave të përgjithshme lidhur me rolin që kanë kredit e ofruara në zhvillimin e bizneseve të vogla me fokus në rastin e ProCredit Bank në qytetin e Mitrovicës. Përmes këtij studimi do të kuptojmë ndikimin që këto kredi e kanë në zhvillimin e bizneseve, metodat që ProCredit Bank i përdor, dokumentacioni i nevojshëm për të aplikuar për kredi si dhe ofrimi i një pasqyre më të përgjithshme lidhur me zhvillimin e sistemit bankar në Kosovë duke u ndalur në analizimin më të thellë të bankës ProCredit.

Ky hulumtim ofron informacione lidhur me performancën e ProCredit Bank dhe arsyet e përzgjedhjes së kësaj banke nga klientët, andaj, nga ky hulumtim do të përfitojë komuniteti duke u mirë informuar lidhur me mundësinë e marrjes së kredive për hapjen apo zhvillimin e bizneseve.

Ky punim është ndërtuar mbi tri hipotezat kryesore të cilat kanë synim të kuptojnë rolin e kredive në zgjerimin e biznesve të vogla dhe të mesme. Pjesmarrës në këtë hulumtim janë 50 pronar të biznesve të vogla dhe të mesme nga rajoni i Mitrovicës. Anketa ishte metoda përmes së cilës u realizua ky punim, dhe rezultatet e tij konfirmojnë hipotezat e ngritura në fillim të hulumtimit.

Fjalë kyçe: ProCredit Bank, roli i kreditimit, bizneset e vogla.

ABSTRACT

The main purpose of this study in Master's thesis is to provide general information regarding the impact of the loans offered in the process of development of the small business with a focus on ProCredit Bank's case in the city of Mitrovica. Through this study we will understand the impact these loans have on business development, the methods that ProCredit Bank uses, the necessary documentation to apply for loans and a general overview regarding the development of the banking system in Kosovo by going into deeper analysis of ProCredit bank.

This research provides information on the performance of ProCredit Bank and the reasons why client have chosen ProCredit Bank as their main bank, which aims to benefit the community by being well informed about the possibility of obtaining loans for opening business or improving their existing ones.

This paper is based on three main hypotheses aimed at understanding the role of credit in expanding small and medium-sized businesses. Participants taken part in this research are 50 owners of small and medium-sized businesses in Mitrovica region. The entire analysis that are provided by this paper were carried out by the survey realized with businesses, and its findings confirm the hypotheses raised at the beginning of the research.

Keywords: ProCredit Bank, Loan Impact, Small businesses

Përmbajtja

Kapitulli I: Hyrja

<i>1.1 Hyrje.....</i>	<i>3</i>
<i>1.2 Qëllimi i studimit.....</i>	<i>9</i>
<i>1.3 Hipotezat e studimit.....</i>	<i>10</i>
<i>1.4 Përshkrimi i studimit.....</i>	<i>11</i>

Kapitulli II : Roli I Kredive – Rishikim i literatures

<i>2.1 Roli i kredive – Vështrimi I përgjithëshëm.....</i>	<i>12</i>
<i>2.2 Definimi i kredisë.....</i>	<i>13</i>
<i>2.3 Historia e zhvillimit të bankave</i>	<i>13</i>
<i>2.4 Rëndësia e sistemit banker</i>	<i>15</i>
<i>2.5 Historia e zhvillimit të sistemit bankare në Kosovë</i>	<i>16</i>
<i>2.6 Roli i kredive në zhvillimin e ekonomisë</i>	<i>20</i>
<i>2.7 Roli i bankave komerciale në bizneset e vogla</i>	<i>21</i>
<i>2.8 Menaxhimi i rrezikut të kredisë</i>	<i>22</i>
<i>2.9 Menaxhimi i portofolit të kredisë</i>	<i>24</i>
<i>2.10 Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit</i>	<i>25</i>

Kapitulli III: Procredit Bank

<i>3.1 Historiku i zhvillimit</i>	<i>26</i>
<i>3.2 Historiku i Procredit Bank në Kosovë</i>	<i>27</i>
<i>3.3 Procredit Bank Kreditë</i>	<i>29</i>
<i>3.4 Çmimorja për kredi – Klientët e biznesit.....</i>	<i>30</i>
<i>3.5 Kredi në Dollar (USD).....</i>	<i>31</i>
<i>3.6 Kreditë me normë të interest të ndryshme.....</i>	<i>32</i>

3.7 Menaxhimi i rrezikut të kreditit në Procredit Bank.....	34
---	----

3.8 Dokumentet e nevojshme për kredi biznesi.....	35
---	----

Kapitulli IV : Metodologjia

Rezultatet.....	36
-----------------	----

Konkluzione.....	49
------------------	----

Rekomandime.....	50
------------------	----

Referencat.....	51
-----------------	----

1.1. Hyrje

Sistemi bankar i Kosovës përbëhet nga banka qendrore (Banka Qendrore e Kosovës), bankat komerciale dhe institucionet mikrofinanciare. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është institucioni financiar kryesor i vendit e cila punon në përputhje me Ligjet në fuqi, për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Bankat komerciale përbëhen nga kapitali privat, i huaj dhe i përbashkët dhe me kapital privat të përbashkët vendor¹.

Banka komerciale në Kosovë janë: Banka për Biznes, Banka Ekonomike, ProCredit Banka, Raiffeisen Banka, Banka Kombëtare Tregtare e Shqipërisë - Dega në Kosovë, TEB Sh.A., Banka Komerciale e Beogradit Dega në Mitrovicë, NLB Prishtina, Turkiye Cumhuriyeti Ziraat bankasi dhe Turkiye Is Bankasi. Bankat komerciale në Kosovë ofrojnë produkte dhe shërbime të ndryshme, e ndër më të rëndësishmet janë: llogaritë bankare, transferet e parave, depozitat me interes, kredi të ndryshme, kartelat bankare, interneti bankar etj.

Kreditë janë ndër aktivitetet kryesore të bankës prej nga banka klientëve u lejon mjete financiare. Bankat komerciale përmes kredive të dhëna dhe të normës së interesit të caktuar, sigurojnë të ardhurat e veta të cilat i nevojiten për t'i paguar depozituesve të saj interesin e premtuar për depozitat e marra, për të përballuar shpenzimet e veta dhe për të siguruar fitimin që bankat kanë për objektiv të tyre².

Zhvillimi ekonomik nuk mund të ndodh pa pasur një zhvillim të sektorit privat dhe bankat janë ato të cilat mund të ndihmojnë dhe po ndihmojnë këtë sektor. Legjislacioni i viteve të fundit dhe sistemi i përmbaruesëve privat nga ata që përfaqësojnë sistemin bankar është një ndihmesë e madhe në kthimin më të shpejtë të kredive gjë e cila paraqet edhe njëri ndër sfidat e këtij sektori³.

¹Gjocaj, et.al. 2003, fq. 88

²Kryeziu, 2012, fq. 117

³Oda Ekonomike e Kosovës, 2015

Bazuar nga karakteristikat dhe rëndësinë që ka sistemi kreditor në zhvillimin ekonomik të vendit, kreditë e bankave apo kreditë komerciale, edhe pse kanë normat e larta të interesit për to, në një mënyrë dhe në një masë kanë ndikuar në zhvillimin e proceseve ekonomike si dhe në zhvillimit e këtij sistemi.

Megjithëse në Kosovë bankat komerciale apo bankat private e filluan aktivitetin e tyre financiar që nga pas lufta e fundit, e vitit 1999, pra nga viti 2000 ato ndikuan fuqimisht në zhvillimin ekonomik të vendit dhe falë veprimtarisë së tyre kreditore ato shpejtuan dhe nxitën zhvillimin e shumë bizneseve në komunitet⁴.

Kreditimi i individëve, biznesit dhe subjekteve të tjera të cilat kërkojnë kredi në banka është procesi i dhënies hua të fondeve të vendosura në bankë, i cili bazohet sipas kushteve të rëna dakord midis vetë bankës dhe të huamarrësve dhe e cila synim ka zhvillimin e një veprimtarie profitabile për huamarrësin e cila ndikon në zhvillimin e bizneseve.

Teza e magjistraturës që kam zgjedhur në bashkëpunim me mentorin ka të bëjë pikërisht me hulumtim dhe studim në lidhje me ‘‘ Rolin i Kreditimit në zhvillimin e bizneseve të vogla’’ rasti i veçantë kreditë që ofron ProCredit Bankë në Kosovë- Mitrovicë.

Qëllimi i këtij studimi-punimi të magjistraturës është hulumtimi dhe roli i kredive në zhvillimin e bizneseve të vogla që ofron ProCredit Banka në Kosovë, përfitimi i komunitetit nga këto kredi si dhe impakti nga kreditë tek komuniteti.

Duke pasur parasysh rëndësinë që ka dhënia e kredive në zhvillimin e bizneseve të vogla do ta bëjë një punim i cili synon të bëjë një analizë të mirëfilltë të ndikimit të kredive që ka ofruar ProCredit Banka në zhvillimin e bizneseve të vogla në Kosovë.

⁴Kryeziu, 2012, fq.115

1.2. Qëllimi i studimit

Qëllimi kryesor i realizimit të këtij studimi në këtë tezë magjistrature është ofrimi i të dhënave të përgjithshme lidhur me rolin që kanë kreditë e ofruara në zhvillimin e bizneseve të vogla me fokus në rastin e ProCredit Bank në qytetin e Mitrovicës. Përmes këtij studimi do të kuptojmë ndikimin që këto kredi e kanë në zhvillimin e bizneseve, metodat që ProCredit Bank i përdor dhe dokumentacioni i nevojshëm për të aplikuar për kredi dhe ofrimi i një pasqyre me të përgjithshme lidhur me zhvillimin e sistemit bankar në Kosovë duke u ndalur në analizimin me të thellë të bankës ProCredit.

Përmes metodologjisë së përzgjedhur për këtë studim konsideroj që do të marrim të dhënat e nevojshme të cilat do të na shërbejnë që të kuptojmë dhe analizojmë numrin e bizneseve të vogla në qytetin e Mitrovicës, qarkullimin vjetor të tyre, llojin e bizneseve që e hasim më së shumti në këtë qytet, shumën e kredive që e kanë marrur, ku e kanë investuar atë, si ka ndikuar dhënia e kredisë në përmirësimin e jetës në komunitet etj.

Analizat që do t'i publikojmë në këtë studim do ti bazojmë nga të dhënat e publikuara nga raportet vjetore nga banka në fjalë, Bankes Qendrore të Kosovës dhe burime të tjera.

Për qëllim të studimit sa më të lehtë dhe kuptimit më të thellë të temës së zgjedhur po i ndajmë qëllimet e studimit në disa pika si vijon:

- Të kuptoj si kanë ndikuar dhënia e kredive në zhvillimin e bizneseve të vogla në regjionin e Mitrovicës.
- Të nxjerr në pah se sa kredi janë ofruar për zhvillimin e bizneseve të vogla në regjionin e Mitrovicës.
- Ky hulumim do të paraqes rëndësinë e dhënies së kredive në zhvillimin e bizneseve të vogla në regjionin e Mitrovicës.
- Nga ky hulumtim do të kuptohet se si përfiton komuniteti nga kreditë që ka ofruar ProCredit Banka në Kosovë, më saktësisht dega në Mitrovicë.

1.3. Hipotezat e studimit

Bazuar në literaturën e shqyrtuar kemi ngjitur tri hipoteza të ndryshme të cilat pritet t'i vërtetojmë si të sakta apo të pasakta në fund të këtij studimi.

Këto hipoteza janë:

H I : Kreditë e ofruara nga ProCredit Bank kanë ndikuar në hapjen e bizneseve të vogla në regjionin e Mitrovicës.

H II: Kreditë kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e bizneseve të vogla.

H III :ProCredit Bank ka ofruar numrin më të madh të kredive në zhvillimin e bizneseve të vogla në regjionin e Mitrovicës.

Nga nxjerrja e rezultateve finale këto hipoteza do të elaborohen dhe shqyrtohen në mënyrë të detajizuar e cila do të shërbej në ofrimin e të dhënave valide lidhur me kreditë e ofruara nga banka në fjalë dhe ndikimin e tyre në zhvillimin dhe hapjen e bizneseve të vogla në rajonin e Mitrovicës.

Nga literatura ekzistuese e cila është përdorur si burim mbi ndërtimin e këtij studimi kemi vendosur për hipotezat e lartëcekura e cila është në përputhje me pyetjet kërkimore të ngritura në fillim të këtij studimi dhe janë konkretizuar duke u ndarë me qëllim të ofrimit të një pasqyre sa më të qartë të të dhënave.

1.4 Përshkrimi i Studimit

Përmes anketës së përpiluar të bazuar në literaturën e shqyrtuar për këtë studim do të jepen informacione lidhur me performancën e ProCredit Bank dhe arsyet e përzgjedhjes së kësaj banke nga klientët. Andaj, nga ky studim do të përfitoj komuniteti duke u mirë-informuar lidhur me mundësinë e marrjes së kredive për hapjen apo zhvillimin e bizneseve, përvojat nga klientet aktual të kësaj banke do të shërbejnë si udhërrëfyes për klientë të ri të cilët mund të vendosin mbi bankën e tyre të parapëlqyer duke e ditur që konkurrenca në sistemin bankar është faktor kryesor në ngritjen e cilësisë së shërbimeve bankare dhe uljen e kostos së shërbimit.

Përveq përfitimeve që do t'i marr komuniteti nga realizimi i këtij studimi, përfitues indirekt do të jenë edhe vetë bankat të cilat përmes rezultateve të nxjerrura nga ky studim do të mund të vlerësojnë punën e tyre si dhe të identifikojnë nevojat që klientët e tyre i kanë dhe të përpiqen në ofrimin sa më të mirë të shërbimeve bankare.

Përfitues të të dhënave të nxjerrura nga ky studim do të jenë dhe hulumtuesit e tjerë të cilët do të mund të shfrytëzojnë rekomandimet e dalura nga ky studim dhe të ngrisin mundësinë e realizimit të studimeve të tjera dhe do të mund të shfrytëzojnë rezultatet e këtij studimi në studimet e ardhshme që do të realizohen.

2.1. Roli i kredive – vështrim i përgjithshëm

Bankat kryejnë një veprimtari të përafërt si çdo biznes tjetër qëllim i së cilës është realizimi i një aktiviteti ekonomik që kryen shërbime të caktuara dhe realizon kalimin e mjeteve të lira financiare nga ata që i kursejnë tek ata që kanë nevojë për to.⁵

Njëra ndër funksionet kryesore të bankës është dhënia e kredive e cila konsiderohet si një mjet financiar i cili siguron zhvillimin, funksionimin dhe veprimtarinë e bizneseve të vogla.⁶

Kredia (mardhënia kreditore) përkufizohet si një mardhënie huadhënëse-kreditore e cila siguron që kreditori jep një kredi në një vlerë të caktuar reale për shfrytëzim në një kohë të caktuar dhe me disa parakushte të cilat caktohen më parë dhe që kanë një detyrim të kthehet në një kohë të caktuar. Marrëdhënia kreditore është vullnetare dhe bazohet në firmosjen e marrëveshjes së ndërsjellë në formë të shkruar – marrëveshje për kredi. Përmes kredisë mundësohet që mjetet e lira financiare që gjenden tek disa subjekte të mobilizohen, të mbledhen dhe të vendosen në disponim për ata që në një periudhë të caktuar u nevojiten.⁷

Në artikuj të shumtë shkencorë dhe hulumtime të ndryshme por edhe nga praktika e kemi tashmë të njohur që në shumë situata të ndryshme është pikërisht kredia ajo e cila luan rolin thuajse vendimtar në shpëtimin e një biznesi apo në ngritjen e tij. Marrja e një kredive nga ana e biznesve realizohet për shumë qëllime. Fillimisht një pjesë e madhe e parave kërkohen për hartimin e sakt të një skeme biznesore me qëllim që investitori të parashikoj suksesin e tij. Më tutje, rëndësia e kredis fokusohet te rimëkëmbja e një biznesi, investimin në shtëpi, vetura apo mjete të tjera materiale⁸. Megjithatë, përmes këti punimi synohet të tregohet roli i tyre në bizneset e vogla.

⁵ Mançellari, et.al. 2002, fq.371-372

⁶ Thorvaldur Gylfason, 1987

⁷ Velkova, et.al. 2010, fq.100

⁸ Teng Teng Xu, 2012

2.2 Definimi i Kredisë

Termi ‘Kredi’ i referohet një shumë të marrur hua nga një person te një tjetër. Shuma që është marrur në natyrën e kredisë i referohet shumës të cilën huamarrësi i saj duhet ta kthej tek huadhënësi. Kështu, nga pikëpamja e huamarrësit kjo shumë është ‘huamarrja’, ndërsa nga pikëpamja e bankës kjo shumë është ‘kreditimi’.

Kredia mund të konsiderohet si ‘kredi’ e dhënë ku paraja është disbursuar dhe ofrimi i saj është bërë në një datë të mëvonëshme. Kjo shumë e caktuar e parave e marrur nga huamarrësi është një borxh të cilin ai detyrohet ta kthej tek huadhënësi pasi që ajo kredi (ato para) janë dhënë për një qëllim të caktuar dhe për tu kthyer në një periudhë të paracaktuar.⁹

2.3 Historia e zhvillimit të bankave

*‘Banka është një institucion i posaqëm financiar i sistemit monetaro-kreditor që merret me marrjen dhe dhënien e kredive në mënyrë profesionale si dhe me ndërmjetësimin në qarkullimin e pagesave të komitentëve’.*¹⁰

Bankat janë institucione financiare të cilat pranojnë depozita dhe japin hua. Me fjalën ‘Bank’ kuptojmë shoqëri të tilla, si: bankat tregtare, shoqëritë e kursimeve, kredit-bankat e përbashkëta të kursimeve dhe unionet e kreditit.¹¹

Bankat janë institucione financiare të cilat i kanalizojnë fondet prej njerëzve të cilët mund të mos i investojnë tek ata të cilët i përdorin ato në një formë më produktive dhe kështu roli i tyre është shumë i rëndësishëm në përmirësimin e ekonomisë.

Banka ka një historik të gjatë të zhvillimit të saj duke u nisur nga fakti që gjurmët e para të bankave i gjejmë aty tek viti 3000 në Azinë Qendrore më saktë në civilizimin e sumerëve.

⁹Jacoby & Saulnier, 1942

¹⁰Luboteni, 2003

¹¹Mishkini, 2014, fq.6

Kështu, në vitin 1407 është themeluar banka e parë në Gjenovë e cila ishte bankë shumë e madhe dhe dispononte shuma të mëdha mjetesh monetare dhe jepte hua të shumta.¹²

Pas kësaj kohe u hapen edhe shumë bankanë vende të ndryshme (*shembull*: bankat e Venedikut ishin Banco di Rialto 1587-1617 dhe Banco del Giro 1617-1806). Ndërsa, në vitin 1694 themelohet në Angli Bank of England sipas planit të skotlandezit, William Paterson, dhe kjo bankë konsiderohet si banka e parë emisionare moderne në historinë bankare.

Në literaturë hasim ndarjen e Bankave sipas kriterëve të ndryshme: sipas sferave ekonomike apo degëve të cilave banka u jep kredi sipas afatit të punëve etj. Kriteri më i përhapur është ai i cili i klasifikon bankat në bazë të asaj se si i siguron ajo mjetet e nevojshme financiare. Në bazë të këtij kriteri, bankat i ndajmë në:

1. Banka emituese (Qëndrore),
2. Banka komerciale (depozitare),
3. Banka afariste,
4. Banka investive,
5. Banka të specializuara ose të degëve,
6. Banka universale,
7. Banka hipotekare,
8. Banka regjionale dhe Banka për zhvillim,
9. Monobanka dhe
11. Kursimorja.

¹²Luboteni, 2006, fq. 23

2.4 Rëndësia e sistemit bankar

Sektori bankar konsiderohet si një nga sektorët me rëndësi jetike për zhvillimin e ekonomisë së një vendi. Rëndësia e tij vjen si rezultat i aktivitetit ekonomik që e zhvillon në mbledhjen e depozitave dhe dhënien e kredive. Në të gjitha sistemet ekonomike, bankat janë pika kyqe që kanë rol udhëheqës në planifikimin dhe zbatimin e politikës financiare. Rëndësinë e padiskutueshme të bankave në zhvillimin dhe përparimin ekonomik e argumentojmë me krizën e vitit 2008 (në Europë), kohë gjatë së cilës qeveritë zgjodhën shpëtimin e bankave duke vendosur barrën mbi supet e taksapaguesëve.

Zhvillimi i sektorit financiar të një vendi ka një korrelacion me rritjen ekonomike, në mënyrë që bankat të kryejnë funksionet e tyre ato ofrojnë një grup të madh të shërbimeve financiare për të tërhequr klientët dhe për të përmbushur kërkesat e tyre. Rëndësinë e tij sistemi bankar e ka si rezultat i të qenurit ndërmjetësues në prodhimin financiar dhe kreditimin e borxheve të tyre ndaj agentëve që tregohen të gatshëm për ta pranuar dhe përdorur atë¹³.

Sipas një artikulli të botuar në vitin 2008¹⁴ sistemi bankar është një ndërmjetësues financiar i cili pritet të ofroj shërbime themelore financiare për të gjithë.

Bankat konsiderohen si pasqyra e rritjes ekonomike dhe kontributin e tyre mund ta japin në dy mënyra:

- Drejtpërdrejt- duke rritur artikujt e bilancit apo
- Indirekt- përmes financimit.

Në ekonominë globale, rëndësia e sistemit bankar është e qartë duke pasur parasysh se në një kontekst që ndodh përshpejtimi dhe zhvillimi i sistemit të informimit dhe komunikimit ndodh edhe rritja dhe zhvillimi i rrjeteve globale financiare.¹⁵

¹³Driga, 2013

¹⁴Allen & Carletti, 2008

¹⁵Levine, 2004

2.5 Historia e zhvillimit të sistemit bankar në Kosovë

Sipas një hulumtimi të realizuar në Kosovë¹⁶ bankat komerciale apo bankat private aktivitetin financiar e zhvillojnë që nga viti 2000. Edhe para luftës në Kosovë funksionin bankat të ndryshme por ato ishin të një sistemi ekonomik e politik të tejkaluar. Bankat e nivelit të dytë apo bankat komerciale punët e tyre i kryejnë konform ligjit mbi bankat si dhe me udhëzimet e Bankës Qendrore. Karakteristikë e sistemit bankar në vendet e tranzicionit siç është edhe Kosova është fakti që sistemi bankar mund të klasifikohen në dy grupe:

1. Vendet ku ekziston sistemi administrative qëndror planifikues dhe
2. Vendet e ish-Jugosllavisë ku ekziston sistemi vetë-administrativ i decentralizuar.¹⁷

Në ekonominë e tregut, aktualisht në territorin e Republikës së Kosovës, bankat komerciale të cilat veprojnë dhe ushtrojnë aktivitetet e tyre si dhe filialet apo degët e tyre që i kanë shtrirë në tërë hapësirën e saj janë:

1. Banka Ekonomike (aktivitetin financiar e filloi më 28 maj të vitit 2001)
2. Banka për Biznes (veprimtarinë e vet bankare e filloi më 5 prill të vitit 2001)
3. NLB Pishtina
4. ProCredit Bank (aktivitetin e saj në Kosovë, nga periudha e pasluftës)
5. Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C (Në qershor të vitit 2003)
6. Banka Kombëtare Tregtare (e filloi punën në vitin 2007)
7. TEB Sh. A. Bank (ka filluar më 2 Janar të vitit 2008)
8. Turkiye Cumhuriyeti Ziraat bankasi
9. Turkiye Is Bankasi

¹⁶Kryeziu, 2012

¹⁷Luboteni, 2006, fq.110

Të gjitha këto banka kan ndikuar pozitivisht në rritjen e ekonomisë së tregut kosovar që nga paslufta.

Llogaritë, transaksionet dhe vlera	2012	2013	2014	2015
Llogarive të klientëve	1,824,266	1,855,383	1,917,513	1,886,644
Numri i transaksioneve	4,329,678	6,793,430	9,051,427	9,835,056
Vlera e transaksioneve (miliard euro)	5,680,957,532	6,435,180,348	6,830,312,337	7,471,535,498

Tabela 1.¹⁸

Në tabelën 1 janë paraqitur llogaritë, transaksionet dhe vlerat në një periudhë kohore prej vitit 2012 deri në vitin 2015. Siç shihet numri i llogarive të përgjithshme të klientëve (Llogari të rezidentëve A-individuele B-Kompani dhe Llogari të Jo-rezidentëve C-Individual dhe D-kompani) në bankat e Kosovës në vitin 2012 ka qenë 1,824,266 e cila ka shënuar rritje në vitin 2015 duke kaluar në 1,886,644.¹⁹

Nga ana tjetër gjatë këtyre viteve rritje është shënuar edhe në numrin e përgjithshëm të transaksioneve, kështu përderisa në vitin 2012 kishim 4,329,678 transaksione në vitin 2015 ky numër është rritur në 9,835,056. Ndërkaq vlera e këtyre transaksioneve në vitin 2012 ishte 5,680,957,532 në vitin 2015 u rrit në 7,471,535,498

Siç treguam më lartë bankat private në Kosovë aktivitetin e tyre bankar e kanë zhvilluar që nga viti 2000, prej kësaj kohe e deri më tani ndryshime të shumta kanë ndodhur në sistemin bankar Kosovar duke filluar kështu me rritjen e numrit të bankave, zgjerimin e filialeve të tyre, hapjen dhe zgjerimin e nëndegëve bankare, rritjen e numrit të ATM-ëve etj. Tabela e mëposhtme tregon vizualisht ndryshimet në sistemin bankar përgjatë viteve 2012-2015.

¹⁸Raporti i bankes vjetore, 2015 fq. 91

¹⁹Raporti i bankes vjetore, 2015 fq.91

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015
Numri i degëve bankare	43	44	45	45
Numri i nëndegëve bankare	258	245	223	210
Numri i ATM-ëve	483	490	495	540
Numri I POS-ve	8,500	9,000	9,500	9,705
Numri i llogarive E-banking	97,089	131,365	157,761	187,297

Tabela 2.²⁰

Në tabelën 2 janë prezantuar ndryshimet në sistemin bankar që kanë ndodhur përgjatë viteve 2012-2015. Kështu, numri i degëve bankare në vitin 2012 ishte 43 dhe shënoi rritje për dy banka me tepër në vitin 2015. Siç shihet ndryshimin më të madh në rritje e ka pasur numri i llogarive E-banking ku në qershor të vitit 2012 ishte 97,089 dhe ky numër shënoj rritje në vitin 2015 duke arritur në 187,297.

Duke qenë se që nga viti 2000 bankat në Kosovë kanë operuar disa nga ato janë hapur, zhvilluar dhe zgjeruar veprimtarinë e tyre në nëndegë të ndryshme në rajone të ndryshme. Si rezultat i kësaj kanë pësuar ndryshme ndër vite në pjesë të ndryshme. Edhe pjesmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve dhe vlera e transaksioneve me kartela ka ndryshuar. Më poshtë e kemi një tabel tjetër e cila tregon ndryshimet në përqindje të këtyre vlerave.

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015
Vlera vjetore në ATM Tërheqje	873,067,575	936,184,272	996,236,120	1,222,659,417
Rritja vjetore e Kredive në %	4.0%	4.4%	8.0%	7.9%
Rritja vjetore e Depozitave në %	8.6%	7.0%	7.3%	7.3%

Tabela 3.²¹

²⁰BQK-raporti vjetor 2015, fq.69

²¹BQK-raporti vjetor 2015, fq 36

Pra, siç duket vlera vjetore në tërheqje në ATM 873,067,575 sa ishte në vitin 2012 ka shënuar rritje në 1,222,659,417 në vitin 2015. Një ndryshim i dukshëm kuptohet territja vjetore e kredive ku nga 4.0% e vitit 2012 kalon në 7.9% në vitin 2015. Ndërsa te rritja vjetore e depozitave kemi një rënie ku nga 8.6% e vitit 2012 kalon në 7.3% në vitin 2015 sektori bankar është një nga sektorët më të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë së një vendi. Në tabelën 4 janë paraqitur kreditë sipas aktivitetit ekonomik përgjatë viteve 2010-2016. (vlerat janë në Milion €)

Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restaurantet	Tregti tjetër	Shërbime financiare	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	38.2	14.6	127.6	18	109.1	521.2	39.5	18.9	22	113.6	1,022.80
2011	40.5	17.2	136.7	14.5	116.3	606.2	39.9	23.4	55	99.9	1,149.50
2012	43.6	16.2	133.1	15.9	125.2	635.3	38.8	22.7	54.5	108.8	1,194.20
2013	45.8	20.1	131.7	20.8	118.7	640.6	49.2	19.1	68.8	102.6	1,217.40
2014	49.8	19.7	153	20.3	107	674.5	51.4	18.1	60.6	102	1,256.40
2015	59.9	19.2	164.1	17.8	99.5	683	50.7	21.3	94	123.08	1,333.40
TET-2016	59.4	27.3	165.6	19.1	102.1	700.2	45.2	21	99.4	148.1	1,387.60

Tabela
4.²²

Siç duket nga 38.2 milion euro kredi të ofruara në bujqësi në vitin 2010 kjo shumë është rritur në 59.4 milion euro në vitin 2016. Minierat nga 14.6 milion euro kanë kaluar në 27.3 milion euro, prodhimi nga 127.6 sa ishte në vitin 2010 ka kaluar në 165.6 milion euro në 2016, energjetika nga 18 milion euro ka kaluar në 19.1 kredi të ofruara në vitin 2016, sektori i ndërtimtarisë nga 109.1 milion euro në vitin 2010 ka kaluar në 102.1 në vitin 2016, tregtia nga 521.2 milion euro kredi është rritur në 700.2 milion euro kredi të marrura gjatë vitit 2016, Hotelet & Restaurantet nga 39.5 milion euro kredi në vitin 2010 janë rritur në 45.2 milion euro në vitin 2016 e kështu me radhë është vazhduar rritja në fusha dhe shërbime të tjera. Kjo tabelë tregon zhvillimin e madh që ka pasur sistemi bankar në mbështetjen e sektorëve të ndryshëm me kredi të ofruara përgjatë viteve.

²² BQK-Raporti vjetor 2015

2.6 Roli i kredive në zhvillimin e ekonomisë

Roli i kreditimit të mjeteve që i dedikohet klientëve është funksioni kryesor i përdorimit të fondeve financiare. Ndër aktivitetet e shumta që realizon një bankë në veprimtarinë e saj përfshihet edhe dhënia e kredive të ndryshme përmes të cilave huamarrësi mund të operoj me materialet e marra në forma të ndryshme mirëpo ky studim prezanton operimin e atyre materialeve në zhvillimin e bizneseve të vogla.

Sipas Raportit të Bankës qendrore 2010 bankat të cilat veprojnë në Kosovë ofrojnë kredi të ndryshme, si:

- a) Kredi konsumuese të llojeve të ndryshme,
- b) Kredi për përmirësimin e kushteve të banimit,
- c) Kredi për zhvillimin e biznesit, zhvillimin e NVM,
- d) Garancinë bankare etj.

Bazuar nga karakteristikat dhe rëndësinë që ka sistemi kreditor në zhvillimin ekonomik të vendit, kreditë e bankave apo kreditë komerciale, edhe pse kanë normat e larta të interesit për to, në një mënyrë dhe në një masë kanë ndikuar në zhvillimin e proceseve ekonomike si dhe në zhvillimit e këtij sistemi.²³

Me zhvillimin e sistemit bankar në Kosovë krahas kësaj është zhvilluar edhe sistemi i kredive i cili si synim të vetëm ka pasur dhe vazhdon ta ketë rritjen e numrit të kredive të cilat janë parë si shumë efektive në zhvillimin e bizneseve të ndryshme veçmas atyre të vogla.

²³Kryeziu, 2012, fq.118

2.7 Roli i bankave komerciale në bizneset e vogla

Bankat komerciale kanë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin dhe ngritjen e bizneseve të vogla përmes veprimtarive të tyre kredituese, funksioni i tyre i ndarë në tri fusha kryesore (pranimi i depozitave, kredidhënia dhe krijimi i kredive) funksionon në atë formë që i ofron klientit hapsirën e nevojshme për manevrime me mjete dhe mbështetjen e nevojshme ekonomike drejtë realizimit të një veprimtarie të caktuar.

a) Pranimi i depozitave

Pranimi i depozitave paraqet funksionin primar të bankave komerciale dhe në të shumtën e rasteve aty pranohen tre lloje të depozitave: llogaria rrjedhëse, llogaria e kursimeve dhe llogaritë e afarizmit²⁴.

Llogaria rrjedhëse si karakteristikë e ka faktin që depozitat mund të tërhiqen në çdo moment nga pronari i tyre. Llogaritë e kursimeve janë ato llogari në të cilat klienti apo bizneset mund të deponojnë mjetet e tyre prej të cilave mund të realizojnë të hyra interesi por, këto llogari shkaktojnë shpenzime pasi që për to duhet të paguajnë interes. Ndërsa, llogaritë e afarizmit janë depozita me afate të cilat mund të tërhiqen para arritjes së periudhës së afatizimit. Për këto lloje të llogarive bankat ofrojnë një normë të lartë të interesit.²⁵

b) Kredidhënia

Roli i dhënies së kredive paraqet një interes me rëndësi të madhe për bankat. Kreditë ndahen në disa lloje, si:

- ***Kreditë pa afate***- këto janë kredi të cilat shfrytëzohen pa afat të caktuar kohor, si: kartat e kreditit dhe linjat e kredive ndërmjet këtyre dy llojeve të kredive të hapura në të cilat klienti i bankës mban me një limit kreditor të cilin mund ta shfrytëzojë sipas nevojës.
- ***Kreditë me afate***- këto kredi janë të tilla të cilat mund të shfrytëzohen vetëm brenda afatit të caktuar dhe nuk mund të merren përsëri pas pagesës së tyre.

²⁴Dermaku & Hoti, 2013, fq.47

²⁵Dermaku & Hoti, 2013, fq.47

Dhe në këtë kategori të kredive nuk ka limit kreditor të cilin klienti mund ta shfrytëzoj në vazhdimësi.

- **Kreditë e siguruara** – këto lloje të kredisë mbështeten në pasurinë e patundshme të cilën e posedon huamarrësi dhe në rast se ai dështon ta kthej kredi në banka mund ta marr në pronsësi pasurinë e tij të cilin ai e len në formë të kolateralit.
- **Kreditë e pasiguruara**- këto kredi nuk sigurohen me kolateral dhe mund të jenë më të vështira për t'u siguruar nga klienti dhe poashtu janë më të shtrenjtë për normë interesi. Që banka të ofrojë një kredi të tillë ajo bazohet vetëm në historinë kreditore të klientit si dhe në të ardhurat e tij.

c) Krijimi i kredive

Funksioni më i veçantë i bankave komerciale është krijimi i kredisë përkatësisht krijimi i parasë. Depozitat e bankave konsiderohen si para, pasi që nëpërmjet tyre mund të kryhen të gjitha pagesat e mundshme dhe mund të përdoren për blerjen e mallrave dhe shërbimeve.²⁶

2.8. Menaxhimi i rrezikut të kredisë

Rreziku i kredisë mund të definohet si rreziku potencial që një huamarrës mund të dështoj për të përmbushur detyrimet e tij/saj për të kthyer kredinë në pajtim me kushtet me të cilat është dakorduar në fillimin kur ka marrur kredinë. Sipas KBMB-së, qëllimi i administrimit të rrezikut të kredisë është 'që të maksimizojë përqindjen e të hyrave nga rreziku i rregulluar i një banke me mbajtjen e ekspozimit të rrezikut të kredisë Brenda parametrave të pranueshëm'.²⁷

Në detyrën e bankave parimisht duhet të merret në konsideratë marrëdhënia mes rrezikut të kredisë dhe rreziqeve të tjera. Në shumicën e herave suksesi afatgjatë dhe gjithpërfshirës i sistemit bankar është aftësia e menaxhimit efektiv të rrezikut të kredisë e cila është një komponente kritike. Shumë banka pësojnë humbje të mëdha të cilat ndikojnë fuqishëm në gjendjen e tyre financiare dhe përballjen me vështirësi të shumta e kjo vjen si rezultat i rritjes së numrit të kredive që nuk janë shlyer apo siç quhen kredive jo-funksionale apo borxheve të këqija.

²⁶Dermaku & Hoti, 2013, fq. 48

²⁷Hyrje në sektorin bankar, 2006

Megjithatë, ka një mënyrë përmes së ciles bankat kanë arritur të kontrollojnë rrezikun e kredive jo-funksionale dhe atë përmes një numri të proceduareve standard.

Procedurat e tilla kanë qenë prej kohesh një karakteristikë qëndrore e huadhënjes bankare, matja e rrezikut të kredisë vë në pah disa çështje të rëndësishme:

- Madhësia e kredisë nuk është e mjaftushme për të matur rrezikun dhe
- Rreziku i akumuluar i kredisë gjatë transaksioneve të një portofoli.

Në mënyrë të vazhdueshme bankat janë duke kërkuar mënyra të ndryshme për të matur rrezikun e kredisë më me saktësi dhe kjo çështje në vitet e fundit vjen si rezultat i një numri të faktorëve, si:

- Rritja e tregut të kredisë së siguruar dhe kredisë sekondare,
- Evolucion i parakohshëm të biznesit të derivatëve dhe kredisë,
- Dëshira e kompanive për të menaxhuar karakteristikat e rrezikut –të hyrave të financimit të borxhit të tyre në mënyrë më efikase dhe
- Theks i shtuar në sistemet e matjes së performancës me rrezik të rregulluar (ku performancë për pjesë të ndryshme të firmës –bankës vlerësohet në raport me rrezikun e marrë dhe mbështetjen e kapitalit) dhe dëshira për të tregtuar rrezikun e kredisë,

Të gjithë këta faktorë kanë ndikuar në sigurimin e një tregu transparent të ofrimit dhe kthimit të kredive duke u mundësuar bankave të konkludojnë rreth rrezikut potencial të kredive jo-funksionale.²⁸

²⁸ Hyrje në sektorin bankar, 2006

2.9 Menaxhimi i portofolit të kredisë

Për të menaxhuar me mbrojtjen nga mundësia e dështimit të sistemit bankar nga mos kthimi i kredive nga menaxherët kërkohet të zbatojnë parimin e diversifikimit të portfolit. Duke diversifikuar portofolet e tyre të kredisë d.m.th duke zotëruar asetet, të hyrat e të cilave nuk janë të lidhura statistikisht bankat mund të zvoglojnë ndikimin e çdo dështimi duke diversifikuar pa u ndaluar rrezikun josistematik. Një përqëndrim i madh i kredive në një sektor të ekonomisë mund të shkaktojë probleme serioze për bankat .Për shembull në Mbretërinë e Bashkuar shoqëritë e ndërtimit kanë përqëndruar historikisht shumicën e kreditimit të tyre duke financuar blerjen e pronës banesore dhe kështu për këtë arsye kanë pësuar një numër të lartë të kredive me problem kur tregu i strehimit u shemb.²⁹

Kur vlerësojmë rrezikun e kreditit të agregatit të portofolit të kredisë menaxherët e bankës duhet bërë llogaritjet si më poshtë.

- Humbje e pritur për çdo kredi dhe për të gjithë portofolin gjatë një horizonti kohor specifik
- Humbje e papritur për çdo kredi dhe për të gjithë portofolin (d.m.th.) paqëndrueshmëria e humbjes
- Mundësia e shpërndarjes së humbjes së kredisë për portofolin dhe vlerësimi i kërkesës së kapitalit për një nivel të caktuar të besimit dhe horizontit kohor.

Ekzistojnë tre faktorë që nxisin humbjet e pritura dhe të papritura në një portofol të kredisë:

- Rreziku i mospagimit të klientit- përcaktohet nga profili i shkallës së rrezikut të portofolit
- Ekspozimi- shuma që ka të ngjarë të mbetet e papaguar në kohën e mospagimit
- Humbja e shkaktuar nga mospagimi - përcaktohet nga niveli i mbuluar i sigurisë
- Efektiviteti i procesit të rimëkëmbjes dhe ciklit të kreditit.

²⁹ Hyrje në sektorin bankar, 2006

2.10 Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Menxhimi I qëndrueshëm i likuiditetit mund të zvogëlojë probabilitetin e problemeve serioze. Rëndësia e likuiditetit shkon përtej bankës individuale pasi një mungesë e likuiditetit në një institucion të vetëm mund të ketë pasojë të mëdha në tërë sistemin.³⁰ Nëqoftëse një bankë ka një problem të përkohshëm të likuiditetit dhe ajo ose nuk është në gjendje ose jo e gatshme për të marrë hua në tregun ndërbankar, banka qëndrore mund të sigurojë fonde në formën e huave dhe paradhënie. Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit synon mbrojtjen e një banke ndaj rrezikut të likuiditetit që do të thotë për të shmangur problemet e likuiditetit një bankë mund të mbajë asetet likuide. Ka një lëshim reciprok mes likuiditetit dhe profitabilitetit, sa më likuid aq më e ulët përqindja e të hyrave. Në vend që të mbajë fonde likuide një bankë mund të krijojë kredi më fitimprurëse. Pavarësisht kostove megjithatë mbajtja e aseteve likuide është e nevojshme pasi ajo:

- Siguron kreditorët që banka është e sigurt dhe në gjendje të përmbushë detyrimet e saj
- Jep sinjale në treg që banka është e kujdesshme dhe e menaxhuar mirë
- Siguron që të gjitha zotimet e kreditimit mund të plotësohen
- Shmang shitjen e detyruar të aseteve të bankës
- Shmang nevojën për të paguar shpenzimet e tepërta të huamarrjes në tregjet ndërbankare dhe
- Shmang huamarrjen nga banka qëndroretë shmangur një situatë të aseteve neto me likuiditet negativ.³¹

³⁰Hyrje në sektorin bankar, 2006

³¹Hyrje në sektorin bankar, 2006

3.1 Historiku i zhvillimit

Sipas informacioneve të marrura nga faqja online e ProCredit Bank, kjo bankë konsiderohet pionere në zhvillimin e sektorit financiar. ProCredit Bank u themelua në vitin 1998 e njohur si IMI AG nga firma IPC dhe filloj aktivitetin e saj falë shumë punonjsëve të IPC-së të cilët investuan në të. Por, të dhënat që ofron banka flasin që themelimi i bankës nga IPC ishte vetëm një fazë shumë e rëndësishme e zhvillimit të saj pasi që përvoja e bankës në financim ka një histori të zhvillimit 25 vite para themelimit të saj zyrtar. Kështu, aksionarët e themelimit të bankës ishin Fondacioni FEFAD, ProCredit Holding (njohur si IMI), Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe Korporata Ndërkombëtare Financiare. (www.procredit-holding.com) ProCredit Holding pasi nisi funksionimin e tij dhe tregohet tejet i suksesshëm në treg i bleu aksionet e EBRD-së e kështu e forcoi edhe më tej pozicionin e saj brenda bankës. Sipas informacioneve të ofruara nga banka ky kapital me tutje u rrit vazhdimisht dhe aktualisht arrin në 15.8 milion euro. Pastaj, në vitin 2003 ky institucion financiar qëllimin i të cilit ishte forcimi financiar i bizneseve të vogla e mori emrin “ProCredit Bank”.

Tani, disa vite më vonë flasim për një bankë e cila konsiderohet ndër më të suksesshmet dhe më të besueshmet, qëllimi i së cilës është ofrimi i shërbimeve në vendet e Europës Qëndrore dhe Lindore, ofrimi i shërbimeve për klientët dhe një gamë të gjërë të produkteve të ndryshme bankare. ProCredit Bank është një grup i bankave të specializuar në ofrimin e shërbimeve për zhvillimin e bizneseve të vogla, promovimin e njerëzve të suksesëshëm në bizneset e tyre dhe ofrimin e mbështetjes financiare për ekonomitë në tranzicion. ProCredit Bank në Shqipëri u themelua në vitin 1995 e njohur me emrin si “Fondacioni për Sipërmarrje, Financë dhe Zhvillim” (FEFAD) në të cilin 100% e kapitalit aksionarë sigurohej nga KFW.³² Fokus i institucionit ishte të siguronte mundësi të financimit për bizneset shqiptare të vogla.

³²www.procreditbank-kos.com

3.2 Historiku i ProCredit Bank në Kosovë

Si një vend i dalur nga lufta ekonomia e Kosovës ishte shkatërruar pothuajse plotësisht, andaj, banka në fjalë ka rifokusuar strategjitë e saja operative duke rritur në mënyrë signifikante operacionet kreditore të cilat edhe paraqesin aktivitetin kyç të kësaj banke.

ProCredit Bank ishte banka e parë e themeluar në Kosovën e pasluftës. Kjo bankë është pasardhëse e MicroEnterprise Bank e cila ishte banka më e suksesshme në Kosovë që nga viti 2000. Duke pasur parasysh urgjencën në themelimin e një infrastrukture të përgjithshme financiare në ekonominë e shkatërruar të Kosovës së pasluftës Procredit bank ishte mobilizuar në mbledhjen e një sasive të madhe të fondeve nga donatorë të ndryshëm për Kosovën dhe si rezultat i kësaj është shëndrruar në bankën kryesore të kursimeve. Sipas burimeve të bankës online kjo bankë ka ofruar në pranverën e vitit 2002 kartelat e para bankare. Banka ProCredit është pasardhëse e MicroEnterprise Bank-ës e cila në vendin tonë në Kosovë është themeluar nga disa institucione financiare të njohura ndërkombëtarisht. Kështu, në vjeshtën e vitit 2003 nga instituti financiar siç ishte themeluar në fillim është riemërtuar në emrin e saj ProCredit Bank e ky hap shënoi edhe antarësimin e kësaj banke në rrjetin ProCredit. Ndërkohë që në vitin 2003 banka ka ndryshuar strukturën e saj ekonomike duke rritur numrin e operacioneve kreditore të cilat paraqesin biznesin kyç të bankave të ProCredit.

Kjo bankë është një bankë zhvillimore e cila ofron shërbime të plota klientëve të saj në një gamë të gjërë të produkteve. Në operacionet kreditore ProCredit Bank përqëndrohet në dhënien e kredive për ndërrmarjet e mëdha, të mesme dhe të vogla pasi që politika e bankës konsideron se krijimi i një numri të madh të vendeve të punës i kontribuon ekonomisë së shtetit.

Vizioni i ProCredit Bank

Politika e përgjithshme mbi të cilën është ngritur e zhvilluar ProCredit Bank në të gjithë botën bazohet në komunikimin e hapur dhe transparent në mes të stafit, andaj ndër vite të funksionimit të bankës rëndësi e madhe i është kushtuar procesit të rekrutimit dhe përzgjedhjes së vazhdueshme të stafit sa më professional. ProCredit Bank gjithashtu si vizion të saj e ka krijimin e një atmosfere të mirë pune ku respektohet mirëqenia psikologjike e punonjësve të saj dhe kështu ndërtohet një ambient i këndshëm pune me komunikim afatgjatë dhe perspektiv reciproke.³³

Misioni i ProCredit Bank

ProCredit Bank është bankë e orientuar drejtë zhvillimit të shërbimeve cilësore për biznese të vogla dhe të mesme si dhe për klientë të cilët dëshirojnë të kursejnë parat e tyre në këtë bankë. Duke u bazuar në këtë ProCredit i përmbahet një numri të parimeve bazë:

- a) Vlersimi i transparencës gjatë komunikimit me klientët,
- b) Nuk provomohet kredia konsumuese,
- c) Përkushtimi në uljen e ndotjes mjedisore,
- d) Ofrimi i shërbimeve bazuar në gjendjen e klientit dhe
- e) Analiza e shëndoshë financiare.

Fokusi i vazhdueshëm i bankës në fjalë është ofrimi i shërbimeve për biznese të vogla dhe të mesme me bindjen që këto biznese krijojnë numrin më të madh të vendeve të punës dhe japin kontribut thelbësor ekonomive në të cilat operojnë.

Në mënyre që të jetë sa me afër klienteve dhe të ofroj shërbime sa më cilësore Procredit Bank e Kosovës ka rreth 41 njësi të shpërndara në të gjitha regjionet e Kosovës me degët respektivisht nëndeget e saja. Ndër të tjerat Procredit Bank e Kosovës nëpërmjet qendrës së thirrjeve në numrin kontaktues+381(38)555 555 ofron edhe informacione dhe shërbime 24/7.³⁴

³³ www.procreditbank-kos.com

³⁴ www.procreditbank-kos.com

3.3 ProCredit Bank- Kreditë

Siç është cekur disa here në këtë punim mbi kreditë e ofruara nga ProCredit Bank dhe po ashtu shqyrtimi i historikut të bankës të ofrojnë një pasqyrë e cila qartazi tregon që kjo bankë është themeluar duke pasur për qëllim ofrimin e kredive të ndryshme në mbështetje të bizneseve të vogla. ProCredit Bank ofron disa lloje të kredive:

- Kredi për renovim të shtëpisë

Shuma minimale për të marrur një kredi për renovim të shtëpisë në ProCredit Bank është 3,000 Euro dhe kohëzgjatja e kredisë është 120 muaj.

- Kredi hipotekare

Shuma minimale për të marr një kredi hipotekare në ProCredit Bank është 10,000 Euro dhe kohëzgjatja e kredisë është 180 muaj.

- Kredi private

Shuma minimale për të marrur një kredi private në ProCredit Bank është 1,000 Euro dhe kohëzgjatja e kredisë është 60 muaj.

- Kredi për shkollim

Shuma minimale për të marrur një kredi për shkollim në ProCredit Bank është shuma varësisht çmimit që përcakton institucioni shkollor dhe kohëzgjatja e kredisë është 60 muaj.

- Kredi e siguruar me para të gatshme

Shuma minimale për të marrur një kredi me para të gatshme në ProCredit Bank është 1,000 Euro dhe kohëzgjatja e kredisë është 60 muaj.

3.4 Çmimorja për kredi – Klientët e biznesit

ProCredit Bank për klientët e saj ofron kredi për të mbështetur biznese dhe agrobiznese të ndryshme. Më posht e kemi paraqitur tabelen e cila pasqyron shumat e kredive të ofruara, normat e interesit si dhe shpenzimet e munëshme administrative.

Shuma e Kredisë (Euro)	Normat e interesit	Shpenzime administrative
Kredi (biznese dhe agrobiznes shumë të vogla)		
20,000-100,000	10.00%-11.50% p.v.	0.50%-1.00%
Mbitërheqje (biznese dhe agrobiznese shumë të vogla)		
10,000-100,000	12.5%-14.00% p.v.	0.5%-1.00%
Linjë kreditore (biznese dhe agrobiznese shumë të vogla)		
10,000-100,000	12.00%-13.5% p.v.	0.5%-1.00%
Kredi (biznese dhe agrobiznes të vogla dhe të mesme)		
> 50,000	9.00%-11.00% p.v.	0.50%-1.00%
	7.50%-9.00%p.v. (për biznese të mesme)	0.50%-1.00%
Mbitërheqje (biznese dhe agrobiznese të vogla dhe të mesme)		
> 50,000	12.00%-13.00% p.v.	0.50%-1.00%
	9.00%p.v. (për biznese të mesme)	0.50%-1.00%
Linjë kreditore (biznese dhe agrobiznese të vogla dhe të mesme)		
> 50,000	11.50%-12.50% p.v.	0.50%-1.00%
	8.50%-9.0% p.v. (për biznese të mesme)	0.50%-1.00%

Tabela 5.³⁵

³⁵ www.procreditbank-kos.com

3.5 Kredi në Dollar (USD)

Duhet të përmendim që një karakteristik me të cilën veçohet ProCredit Bank është ofrimi i kredis në dollar. Nga tabela e kuptojm që kredit ofrohen nga 20,000 deri në 50,000 me normë interesi 14.40% p.v ndërsa nga 50,000 deri në 500,000 norma e interesit është 12.00% p.v.

Shuma e Kredisë	Norma e interesit	Kohëzgjatja e kredisë	Shpenzimet administrative
Kredi biznesi			
Nga 20,000 deri në 50,000	14.40 % p.v.	3-24 muaj	2.00%
Nga 50,000 deri në 500,000	12.00 % p.v.	3-24 muaj	1.00%
Mbitërheqje			
Nga 10,000 deri në 50,000	16.00 % p.v.	3-12 muaj	1.00%
Mbi 50,000 deri në 500,000	12.00 % p.v.	3-12 muaj	0.50%
Linjë kreditore			
Nga 10,000 deri në 50,000	16.00 % p.v.	3-12 muaj	1.00%
Mbi 50,000 deri në 500,000	12.00 % p.v.	3-12 muaj	0.50%

Tabela 6.³⁶

³⁶<https://www.procreditbank-kos.com/sq/Cmimorja->

3.6 Kreditë me normë interesi të ndryshme

Kreditë me normë interesi të ndryshueshme	Kohëzgjatja e kredisë	Norma e interesit	Shpenzimet administrative
Për biznese shumë të vogla	Mbi 60 muaj	7.00% + EURIBOR 6 muaj	1.00%-1.50%
Për biznese të vogla	Mbi 60 muaj	7.00% + EURIBOR 6 muaj	0.50%-1.00%
Për biznese të mesme	Mbi 60 muaj	6.50% + EURIBOR 6 muaj	0.00%-0.50%
Kreditë me normë interesi të ndryshueshme			
Për biznese shumë të vogla	Mbi 60 muaj	7.00 % + norma mesatare e depozitave	1.00%-1.50%
Për biznese të vogla	Mbi 60 muaj	7.00 % + norma mesatare e depozitave	0.50%-1.00%
Për biznese të mesme	Mbi 60 muaj	6.50 % + norma mesatare e depozitave	0.00%-0.50%
KREDI TË SIGURUARA ME PARA TË GATSHME			
Për biznese dhe agrobiznese shumë të vogla	Deri në 60 muaj	Duke filluar nga 2.00% p.v. mbi normën e interesit në depozitën me afat	0.00%
Për biznese dhe agrobiznese të vogla	Deri në 60 muaj	Duke filluar nga 2.00% p.v. mbi normën e interesit në depozitën me afat	0.00%
Për biznese dhe agrobiznese të mesme	Deri në 60 muaj	Duke filluar nga 2.00% p.v. mbi normën e interesit në depozitën me afat	0.00%
MBITËRHEQJE TË SIGURUARA ME PARA TË GATSHME			
Për biznese dhe agrobiznese shumë të vogla	Deri në 12 muaj	Duke filluar nga 2.50% p.v. mbi normën e interesit në depozitën me afat	0.00%
Për biznese dhe agrobiznese të vogla	Deri në 12 muaj	Duke filluar nga 2.50% p.v. mbi normën e interesit në depozitën me afat	0.00%

Për biznese dhe agrobiznese të mesme	Deri në 12 muaj	Duke filluar nga 2.50% p.v. mbi normën e interesit në depozitën me afat	0.00%
LINJË KREDITORE TË SIGURUARA ME PARA TË GATSHME			
Për biznese dhe agrobiznese shumë të vogla	Deri në 12 muaj	Duke filluar nga 2.25% p.v. mbi normën e interesit në depozitën me afat	0.00%
Për biznese dhe agrobiznese të vogla	Deri në 12 muaj	Duke filluar nga 2.25% p.v. mbi normën e interesit në depozitën me afat	0.00%
Për biznese dhe agrobiznese të mesme	Deri në 12 muaj	Duke filluar nga 2.25% p.v. mbi normën e interesit në depozitën me afat	0.00%

Tabela 7.³⁷

Nga tabela e paraqitur kuptojmë që ProCredit Bank ofron kredi për biznese shumë të vogla me kohëzgjatje të kredis mbi 60 muaj dhe norma e interesit është 7.00%. Për biznese të vogla gjithashtu ofrimi i kredis është në kohëzgjatje prej 60 muaj dhe me norma interest prej 7.00%. Mirëpo kjo normë interesi ndryshon kur është fjala për ofrimin e një kredie për bizneset e mesme ajo kalon në 6.50%.

Gjithashtu ProCredit bank ofron edhe kredi me para të gatshme për biznese dhe agrobiznese e cila po ashtu zgjat deri në 60 muaj dhe ka normë interesi duke filluar nga 2.00% p.v. Ndërsa, mbitërheqja e siguruar me para të gatshme për biznese dhe agrobiznese të vogla ka një kohëzgjatje prej 12 muaj dhe një normë interesi duke filluar nga 2.50% p.v. mbi normën e interesit në depozitën me afat. Gjithashtu linja kreditore e siguruar me para të gatshme për biznese dhe agrobiznese të vogla ka një kohëzgjatje prej 12 muajve dhe me normë interesi duke filluar prej 2.50% p.v. mbi normën e interesit në depozitën me afat.

³⁷ www.procreditbank-kos.com

3.7 Menaxhimi i rrezikut të kreditit në ProCredit Bank

Kreditimi i bizneseve të vogla është operacioni kryesor i ProCredit bankës i cili është mjaft i rrezikshëm nga fakti që huamarrësit mund të mos jenë në gjendje të shlyejnë borgjin dhe kështu banka mund të përballet me probleme financiare. Konsiderohet se rreziku më i madh i një banke vjen pikërisht nga kreditë e ofruara andaj, ProCredit Bank i duhet një menaxhim efikas në kontekstin e llogaritjes së kapacitetit për të mbajtur rrezikun.³⁸

Andaj, ProCredit Bank realizon politika të tilla që parashikojnë rrezikun dhe mbajnë në kontroll huamarrësit kështu, për çdo klient të vetëm të bankës një kufi të ekspozimit të kredisë është vendosur dhe kreditit vendimmarrjes autoriteti është përcaktuar qartë; të gjitha vendimet për të nxjerrë një kredi, ose të ndryshoj kushtet e saj, janë marrë nga një komitet krediti, dhe të gjitha vlerësimet e rrezikut të kreditit janë të dokumentuara me kujdes.

Pasi që pjesa më e madhe e kredive të bankës janë të pagueshme në këste mujore, dështimi i një huamarrësit për të përmbushur një afat të pagesës trajtohet si një shenjë fillestare e dështimit të mundshëm dhe tërheq një përgjigje të menjëhershme nga banka. Kur pagesa e interesit ose principalit është vonuar më shumë se 30 ditë, kredia në fjalë është caktuar për portofoliot në rrezik (PAR > 30), e cila shërben si indikator kyç për cilësinë e portofolit të kredisë dhe për matjen e kreditit klasike rreziku.

³⁸ www.procreditbank-kos.com

Dokumentat e nevojshme për Kredi Biznesi

Dega/banka:

Emri i kompanisë:

Numri i aplikacionit:

Në vijim është paraqitur dokumentacioni i kërkuar nga banka për një kredi biznesi:

- Pasqyra e të ardhurave dhe bilanci i gjendjes
- Rjedha e parasë, historiat e kreditorit, propozimi për plan të amortizimit
- Përmbushja e kriterve minimale sipas udhëzuesit
- Foto nga biznesi
- Foto të kolateralit të pasurisë së patundshme (nëse është e nevojshme)
- Dosja informative e klientit (customer information file) dhe verifikimi i listës së zezë
- Vonesat e kredisë (nëse klienti ka histori kreditore me bankën XY)
- Verifikimi në RKK(regjistri i kreditorit të Kosovës)për huamarrës /garantues etj.
- Regjistrimi i biznesit dhe konfirmimi
- Kopja e letonjoftimit të pronarit të biznesit, bashkhuamarrësit, garantuesit ose të tjerëve.
- Lista poseduese dhe kopja e planit nëse sigurohet me patundshmëri
- Kolaterali-lista e inventarit e nënshkruar dhe e vëltur nga klienti / huamarrësi
- Kolaterali-paisjet e makinerisë e nënshkruar dhe e vëltur nga klienti / huamarrësi
- Dokumentet valide të automjetit të regjistruar
- Historiat e pagesës së kredisë së mëparshme / në bankat tjera-ekstrakti i bankës
- Certifikata e TVSH për shumën mbi 80,000Euro
- Kontrata për shit-bleje për kredi hipotekare
- Konfirmimi i blerjes dhe sigurimi CASCO (për Auto-kredi).
- Raporti i Kreditor(CRK),Historiat e Kreditorit, propozimi për plan të amortizimit
- Përmbushja e kriterve minimale të parapara

KREU IV: Metodologjia

Për realizimin e këtij hulumtimi kemi përdorur një pyetësor të hartuar duke u bazuar në shqyrtimin paraprak të literaturës. Ky pyetësor ka përmbajtur gjithsej 23 pyetje të mbyllura prej të cilave përgjigje të ofruara duhej të zgjedhej personi i cili ishte pjesmarrës në këtë hulumtim. Pyetësi ka synuar që të grumbulloj të dhëna lidhur me bankën në përgjithësi, rolin e kredive në biznese dhe statisfaksionin e klientëve me bankën. Për qëllim të kuptimit më të saktë dhe nxjerrjes së konkluzioneve të besueshme dhe të vlefshme më poshtë po i paraqesim të gjitha pyetjet e pyetësit të elaboruara dhe të prezantuara në grafikun.


Rezultatet

Në komunën e Mitrovicës sipas të dhënave të bizneseve të regjistruara deri në vitin 2015, janë gjithsej 6700 biznese.³⁹

Gjatë përzgjedhjes së mostrës së bizneseve të cilat do të behën pjesë e këtij hulumtimi kujdes të vecantë i kemi kushtuar edhe reprezentimit të femrave ndërmarrëse të cilat edhe pse në numër të vogël në bazë të statistikave shtetëore kanë ndikim në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Statistikat për qytetin e Mitrovicës tregojnë se prej gjithsej 6700 bizneseve, 67 janë biznese në pronesi të grave ose vetëm 1% ne total të bizneseve që afarojnë në Mitrovicë.

³⁹ <https://kk.rks-gov.net/mitrovice/Municipality/Zyrat-Njesite/Qendra-komunale-e-Biznesit.aspx>

GJINIA



Grafiku 1

Nga mostra e zgjedhur prej 50 binzeseve që kanë qenë pjesë e këtij hulumtimi, ku të gjitha kanë qenë klientë të bankës ProCredit të cilet kanë pasur ose kanë kredi ekzistuese në këtë bankë e poashtu edhe produkte tjera që ofrohen nga banka. Prej ketyre bizneseve, pronar meshkuj janë 35 ndërsa 15 të tjera janë pronare femra ose 70% meshkuj dhe 30% femra.


Sektori në të cilin operon biznesi?



Grafiku 2

Ndonëse Mitrovica i përket rangut të qyteteve industriale, kjo gjë ka ndryshuar viteve të fundit për shkak se shumë biznese të pasluftes i'u është pamundësuar rivitalizimi dhe kthimi i këtyre paisjeve të vjetëruara për prodhim të mëtutjeshëm. Si rezultat i kësaj, sektor dominant pas luftës e deri më sot vazhdon të jetë tregëtia me shumicë dhe pakicë, transporti, ndërtimtaria si dhe bujqësia.


Siç edhe tregojnë statistikatat për sektorin e bizneseve të cilat operojnë në përqindje më të madhe, tregtia del të jetë sektori dominant i bizneseve i cili ka përdorur bankën ProCredit dhe në përgjithësi produktet kreditore si burim financimi të biznesit me 30% ose 15 biznese prej total 50 bizneseve të intervistuar të cilat përdorin shërbimet bankare. Pas sektorit të tregtisë vie sektori i shërbimeve me 16% ose në numer prej 8 bizneseve, për të vijuar më pastaj me prodhimtarinë dhe sektorin e ndërtimtarisë. Sektori i ndërtimtarisë është sektori me më se paku financim nga bankat për arsye se konsiderohet si biznes me risk më të lartë, ku përqindjen më të madhe të kredive të dështuara nga bizneset vie nga ky sektor.



Grafiku 3, 4, 5


Biznese dominante në qytetin e Mitrovicës edhe më tutje vazhdojnë të jenë bizneset familjare, biznese të cilat janë themeluar në baza vetanake nga fondet e mbledhura familjare. Si rezultat i kësaj edhe statusi i themelimit ka qenë i tillë që kanë filluar direkt me kryerjen e shërbimeve pa bërë planifikime bazë të parashikimeve financiare për vitet në vijim. Nga bizneset e anketuara, 96% prej tyre nuk kanë plan biznesi ndërsa vetëm 4% prej 50 bizneseve të anketuara posedojnë plan biznesi. Statistikat tregojnë se sa i përket organizimit biznesor, dominojnë bizneset individuale me 36 biznese dhe 4 tjera si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Përderisa, nga bizneset e anketuara të cilat përdorimin ProCredit si burim financimi për qëllime të rritjes së prodhimit ose planifikimit të zgjerimit të biznesit, bizneset individuale familjare përmbajnë përqindjen më të madhe prej 72% dhe pjesa e mbetur prej 28% i'u përket formave tjera të organizimit të biznesit. Siç edhe mund të shihet nga forma e organizimit të bizneseve, bizneset

individuale janë biznese të cilat kanë një pronar dhe e kanë patjetër që të financohen nga banka pasi nuk kanë burime tjera financiare.



Grafiku 6, 7, 8, 9

Qyteti i Mitrovicës karakterizohet kryesisht me biznese më të vogla për sa i përket numrit të puntorëve me vetëm disa biznese të mëdha që i kalojnë mbi 50 puntorë. Prej gjithsej bizneseve të cilat afarojnë në Mitrovicë, 6,634 janë biznese të vogla që numërojnë 1-9 punëtorë, 57 biznese kanë 10-49 punëtorë, ndërsa vetëm 9 prej numrit të bizneseve janë biznese të cilat kanë më tepër se 50 puntorë. Nga bizneset e anketuara përqindjen më të madhe e mban kategoria e biznesit me 1-9 të punësuar saktësisht 37 biznese ose 74% në pjesëmarrjen totale të bizneseve. Ndërsa si biznes i mesëm 10-49 punëtorë janë 22% e bizneseve të cilat kryjnë aktivitetin e tyre ekonomik në qytetin e Mitrovicës, ndërsa pjesa tjetër prej 4% punësojnë mbi 50 punëtorë.




Grafiku 10, 11


Pasi statistikën tregojnë se shumica e bizneseve që afrojnë në Mitrovicë janë biznese të vogla me numër të vogël të punëtorëve, qarkullimi vjetor i tyre është e natyrshme të jetë më i ulët. Rreth 50% e bizneseve të anketuara ose 25 në numër kanë si qarkullim vjetor ndërmjet 20.000-40.000 euro, 18% me qarkullim vjetor ndërmjet 40.000-70.000 euro si dhe rreth 32% me mbi 70.000 euro qarkullim vjetor. Shumica e këtyre bizneseve tregojnë se financimi përmes kredisë rezulton të ketë ndikuar dukshëm në rritjen e qarkullimit vjetor.

Të gjitha bizneset e anketuara pohojnë të jenë klientë të cilët përdorin shërbimet bankare të ProCredit posaqërisht kreditë si formë e financimit të biznesit të tyre, ku rreth 80% e bizneseve kanë marrur kredi për hapjen e biznesit të tyre, ndërsa 20% të bizneseve tjetra pohojnë të kenë filluar biznesin me mjete vetanake. Të pyetur lidhur me shumën e marrur si kredi nga banka ProCredit për qëllime financimi të afarizimit biznesor, kategoria e shumave të kredisë ndërmjet 1.000-5.000 euro del të jetë si shuma më e shpeshtë e marrur kredi nga këto biznese, për të vazhduar më pastaj me 5,000-9,999 euro.


Arsyeja e zgjedhjes së ProCredit Bank:




A mendoni se ProCredit Bank ofron kredi me norma të interesit më të ulëta krahasuar me bankat tjera ?




A ka qenë e nevojshme Hipoteka për të mar kredi në Procredit Bank?



A ishte e nevojshme kolaterali për të mar kredi në Procredit Bank?



Sa mendoni se ju ka ndihmuar ProCredit Bank me kredinë e ofruar:




Grafiku 12, 13, 14, 15, 16

Institucioni i parë kreditor financiar në Kosovë pas luftës ka qenë banka ProCredit por që me emer tjetër Micro Enterprise Bank. Si rezultat i kësaj, arsyet e zgjedhjes së kësaj banke për të financuar bizneset e tyre sepse ka qenë institucioni i vetëm për kredimarrje. Nga bizneset pjesëmarrëse në anketim, 68% e bizneseve deklarojnë se arsyeja e zgjedhjes së ProCredit bank për të marrur kredi është sepse kanë qenë klient të saj që nga fillimi, pastaj si arsye tjetër pse këta tregtare kanë zgjedhur ProCredit është për shkak të normave të interesit, më saktësisht 26% prej tyre. Ndonëse ideja se ProCredit Bank është bankë gjermane, besueshmeria në kryerjen e shërbimeve është më e lartë përderisa tek bizneset e anketuara kjo del të jetë e ulët sa i përket ndikimit si arsye për t'u financuar nga kjo bankë. Ndërsa sa i përket pyetjes nëse banka ProCredit ofron norma të ulëta të interesit, 52% e bizneseve pohojnë se kreditë e marrura nga ProCredit bank janë ofruar me norma me të ulëta të interesit në krahasim me bankat e tjera. Ndonëse nga realiteti e dijmë se banka ProCredit afaron me normat më të larta që ofrohen në treg, mostra e zgjedhur për këtë anketë del të jenë financuar me kushte më të volitëshme. Ndërsa 46% prej këtyre bizneseve, pohojnë se nuk janë në dijeni nëse këto norma kanë qenë më të ulëta ose jo, kjo nga që ka kaluar kohë e gjatë prej se ata kanë marrur kredinë ose janë drejtuar te vetem banka ProCredit duke u'a pamundësuar keqhtu të bëjnë krahasimin me normat e interesit të cilat ofrohen nga bankat e tjera.


Kur banka financon ndonjë biznes, ajo duhet në një formë apo tjetër të sigurohet në kthimin e atyre mjeteve të lëshuara përmes kredisë. Si formë e garantimit të kthimit të atyre mjeteve, banka vendos kushte të caktuara mbi kolateralin e lënë nga ana e biznesit si dhe hipotekës nëse shuma e kredisë është më e lartë. Të pyetur nëse i'u është kërkuar nga bankat të lihet kolateral ose hipotekë gjatë marrjes së kredisë, të anketuarit pohojnë se kolaterali ka qenë i domosdoshëm për çfarëdo shume të financimit ndërsa si hipotekë 68% e tyre pohojnë se nuk i'u është nevojitur hipoteka për t'u financuar nga banka, gjë që edhe rezulton të jetë e arsyeshme meqë sic e kemi përmendur edhe më heret shumat e financimit kanë qenë kryesisht shuma nën 10 mijë euro.

Afarizmi i bizneseve në një vend në zhvillim e siper siç është Mitrovica del të jetë më i vështirë si rezultat i konkurrencës së lartë pothuajse në çdo sektor te bizneset e vogla. Të pyetur se sai'u ka ndihmuar këtyre bizneseve kreditë e marrura, 64% e tyre pohojnë se kreditë i kanë ndihmuar në zhvillimin e mëtutjeshëm të biznesit të tyre, qoftë duke bërë zgjerim biznesi apo blerje të mallit për shitje.




Grafiku 17

Ndërsa, 36% e bizneseve të anketuara pohojnë se kreditë e marrura i'u kanë ndihmuar mesatarisht, kjo nga që konkurenca e tregut ka qenë e lartë në kryerjen e të njejtave shërbime dhe si rezultat i kësaj tregtarët me ekonomizim të shkallës më të lartë kanë mbizotruar tregun në atë sektor. Meqë të gjitha këto biznese pohojnë të jenë ndarë të kënaqura me kreditë e ofruara ngabanka ProCredit, të gjitha pohojnë se do të vazhdojnë t'i qëndrojnë besnik bankës ProCredit.




Grafiku 18, 19



Grafiku 20

Zakonisht kur një biznes vendos të përdor kreditë si burim financimi, plan i shfrytëzimit të këtij burimi financiarë është më i qartë. Të pyetur se në cilat fusha kanë treguar më shumë sukses pas marrjes së kredisë, dominant ka qenë rritjave e shitjeve e cila proporcionalisht vie me rritjen e numrit të klienteve ku mbi 90% pohojnë të ketë ndodhur një situatë e tillë, përderisa në numer më të vogël pohojnë të kenë përdorur këto kredi për qëllime marketinu dhe përmirësimit të infrastrukturës.


Cfarë shërbime tjera përdorni nga ProCredit Bank:



Grafiku 21


Përderisa në fillim-vitet e pasluftes bankat kanë qenë të interesuara në lëshimin e kredive, me zhvillimin gradual të tregut ekonomik ato janë munduar të ofrojnë gamë më të gjerë të produkteve dhe shërbimeve me qëllim të krijimit të një raporti prej të cilit përfitojnë si banka poashtu edhe bizneset. Lehtësimi i procedurave për të marrur mjete financimi, lehtësia në çasje të shërbimeve, mundësia për të kryer këto shërbime kudo ka ndihmuar që bizneset të kenë më të lehtë menaxhimin me transaksione financiare. Nga të anketuarit, pothuajse të gjithë klientët përdorin më tepër se një produkt bankar. Përveç kredisë e cila përdoret nga të gjitha bizneset, Overdrafti duket të përdoret poashtu njëjtë me 99%. Poashtu shërbimet elektronike siç është e-banking del të përdoret nga këto biznese, ku 40% e tyre pretendojnë të kenë përdorur e-banking për kryerjen e pagesave.

Krahasuar me vitin e kaluar, a keni rënie në normat e interesit?



Grafiku 22

Të pyetur nëse ka rënie në normat e interesit për dallim nga viti i kaluar, të gjithë pohojnë se ka ndodhur rënie e përgjithshme në normat e interesit të kredive por që efekti te bizneset e tyre nuk është vërejtur pasi kreditë e marrura më herët kanë qenë me norma fikse të caktuara më herët.



Grafiku 23

Ndërsa, kur këta tregtarë janë pyetur se në rast se do të vendosnin të kalonin në ndonjë bankë tjetër cilat do të ishin arsyet për këtë veprim, 72% e tyre pohojnë se normat e interesit janë pika kyqe gjatë vendosjes së marrjes së kredisë, përderisa 2% pohojnë se arsyet pse do të ndërronin bankën do të ishin nëse bankat tjera ofrojnë shërbim më të shpejtë dhe çasje më të lehtë në shërbimet bankare.

KONKLUSIONE

Pas administrimit të pyetësorëve dhe nxjerrjes së rezultateve për gjithsej 23 pyetjet që pyetësi i përmbante, konkludimi i këtij hulumtimi për hipotezat e ngritura në fillim është si vijon:

- Hipoteza I: Kreditë e ofruara nga ProCredit Bank kanë ndikuar në hapjen e bizneseve të vogla në regjionin e Mitrovicës.

Nga pyetja e 9-të e përgatitur për pronarët e bizneseve e cila kishte synim të kuptonte se a kanë marr ata kredi për hapjen e biznese të tyre 80% të tyre kanë pohuar që kredia e ofruar nga ProCredit Bank është përdorur për qëllim të hapjes së biznesit.. Pra, tani mund të arrijmë në përfundim se nga literatura e shqyrtuar në fillim të këtij hulumtimi mbi bazën e të ciles është ngritur një hipotezë e tillë kjo del të jetë e konfirmuar. Shumica e pronarëve të bizneseve të vogla e kanë përdorur marrjen e kredisë nga ProCredit bank për të hapur biznesin e tyre.

- *Hipoteza II: Kreditë kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e bizneseve të vogla.*

Afarizmi i bizneseve në një vend në zhvillim e siper sic është Mitrovica del të jetë më i vështirë si rezultat i konkurences së lartë pothuajse në çdo sektor te bizneset e vogla. Të pyetur se sa i'u ka ndihmuar këtyre bizneseve kreditë e marrura, 64% e tyre pohojnë se kreditë i kanë ndihmuar në zhvillimin e mëtutjeshëm të biznesit të tyre, qoftë duke bërë zgjerim biznesi apo blerje të mallit për shitje. Edhe nga kjo pikë mund të konkludojmë që marrja e kredisë nga ProCredit Bank ka ndihmuar pozitivisht zhvillimin e bizneseve të vogla në Mitrovicë.

- *Hipoteza III : ProCredit Bank ka ofruar numrin më të madh të kredive në zhvillimin e bizneseve të vogla në regjionin e Mitrovicës.*

Nga 50 biznese që kanë marrur pjesë në këtë hulumtim të gjitha kanë pohuar që kanë marrur kredi në bankën ProCredit, andaj lehtë mund të arrijmë në përfundim se sipas mostrës së përzgjedhur kjo bankë ka ofruar mbështetjen më të madhe të bizneseve të vogla dhe zgjerimin e tyre

REKOMANDIME

Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme që të realizohet një hulumtim sa më korrekt me të dhëna empirike të cilat do të shërbejnë në ofrimin e një pasqyre sa më të qartë për hapjen, zgjerimin dhe kreditimin e bizneseve të vogla në regjionin e Mitrovicës sigurisht se hulumtimi i ka edhe kufizimet e veta.

Megjithatë, rekomandohet qëky hulumtim të merret si pikë reference për hulumtuesit e tjerë të cilët do të studiojnë të njëjtën qështje në vazhdimësi. Gjithashtu konsiderojmë që është shumë e nevojshme që në një hulumtim të radhës me të njëjten problematikë të realizohet edhe pjesa e e intervistimit direkt të menaxherëve të bankës përmes të cilëve do të mund të merreshin të dhëna shumë të dobishme nga perspektiva e bankës dhe do të mund të kuptohej politika e bankës lidhur me kreditimin e bizneseve të vogla në regjionin e Mitrovicës.

BIBLIOGRAFIA

Libra

Frederic. S. Mishkini. (2014). Ekonomia e parasë veprimtarisë bankare dhe tregjet financiare.

Gazmend Luboteni.(2006). Bankat dhe afarizmi bankar.

Arben Dermaku dhe Arbër Hoti, (2013).Kontabiliteti i institucioneve financiare.

Levine R., Finance and Growth: Theory, Evidence & Mechanism, Handbook of Economic Growth, Amsterdam: North-Holland, 2004

Artikuj

R. Kryeziu. (2012). Sistemi bankar kreditor dhe ndikimi i tij në zhvillimin ekonomik.Prishtinë.

Gjocaj, K. Mazreku, I. Gashi, A. (2004). Roli i sistemit bankar në zhvillimin ekonomik.

Mançellari, Ahmet. Dadëri, Sulo., Kule, Dhori dhe Qiriqi, Stefan. Hyrje në Ekonimi, Pegi, Tiranë, 2002.

Allen F., Carletti, E., The roles of banks in financial systems, Oxford Handbook of Banking, 2008

Driga I., Financial crisis and bank profitability - the case of Romania, Annals of the University of Craiova, Economic Sciences Series, pp.34-45, 2013

Neil H. Jacoby & Raymond J. Saulnier (1942).Term Loading to Bussiness. Publisher by NBER

TengTeng Xu (2012). The role of credit in international business cycles.International Economic Analysis Department.Bank of Canada.

Thorvaldur Gylfason (1987). Credit Policy and Economic Activity in Developing Countries with IMF Stabilization Programs.PRINCETON STUDIES IN INTERNATIONAL FINANCE No. 60, August.

Të tjera

Raporti i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, viti 2010.

Raporti i Odes Ekonomike të Kosovës, viti 2015

Raportet vjetore të BQK-së, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015

Raportet e Stabilitetit Financiar të BQK-së, nr.1, 2, 3, 4, 5, 6, 7

Publikim,Raporti vjetor 2012, ProCredit Bank Kosovë

Publikim,Raporti vjetor 2013, ProCredit Bank Kosovë

Publikim,Raporti vjetor 2014, ProCredit Bank Kosovë

Publikim,Raporti vjetor 2015, ProCredit Bank Kosovë

Burime nga internet

[Banka Qendrore e Kosovës \(www.bqk-kos.org\)](http://www.bqk-kos.org)

<http://www.nber.org/chapters/c5750.pdf>.

<http://documents.tips/documents/procredit-bank.html>

[www.procreditholding.com/images/documents/Financials/ProCredit Holding AR 2012.pdf](http://www.procreditholding.com/images/documents/Financials/ProCredit_Holding_AR_2012.pdf)

www.arbk.rks-gov.net

<https://www.procreditbank-kos.com/sq/Cmimorja->

https://www.princeton.edu/~ies/IES_Studies/S60.pdf

<https://www.banqueducanada.ca/wp-content/uploads/2012/11/wp2012-36.pdf>

[Shoqata e Bankave të Kosovës /sektori-bankar \(https://www.bankassoc-kos.com/Al/sektori-bankar/\)](https://www.bankassoc-kos.com/Al/sektori-bankar/)

<https://www.procreditbank-kos.com/>